



shti
AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË

ORGANIZOJNË:



AKADEMIA E SHKENCAVE,
DHE E ARTEVE E KOSOVËS

"Koncert i përbashkët veprash Kamerale-muzikë dhoma"

Znj./Z. _____

Datë 18 tetor 2016, ora 11.00, Akademia e Shkencave; ora 19.00, në sallën e Universitetit të Arteve, UART

PROGRAMI

S. PARADITE, NË AKADEMINË E SHKENCAVE, ORA 11.00

A.

I. "Tribunë muzikologjike" kushtuar jetës dhe krijimtarisë së kompozitorit dhe Akademikut Zeqirja BALLATA, salla "Aleks BUDA".

- Përvendetje nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Përvendetje nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Kumtojnë:

- Prof. Dr. Fatmir Hysi "Aspekte kombëtare në muzikën e Zeqirja Ballatës"
- Dr. Edmond Buharaja "Ballata në kontekstin e kulturës evropiane"
- Dr. Mikaela Minga "Ballata në dhe përmendje muzikologjinë shqiptare"
- Dr. Eno Koço "Pjesë nga krijimtaria e Zeqirja Ballatës në këndvështrimin e dirigjentit".
- Dr. Pandi Bello "Zeqirja Ballata një pararendës i novatorizmit në muzikën shqiptare"

2. "Ekspozitë e botimeve muzikore" të Akademikut Zeqirja BALLATA tek "Libri Akademik"

PARSIDITE, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, UART, ORA 19.00

3. "Koncert me muzikë dhome" me vepra të kompozitorit dhe akademikut Zeqirja Ballata.

PROGRAMI:

- Suite për orkestër harqesh (1966). I. Moderato; II. Allegretto giocoso; III. Andante cantabile; IV. Allegro vivace
Interpreton: Ansambli i Harqeve.

- Trio për violinë, violinçel e piano (1983). I. Adagio; II Allegro sostenuto; III Sostenuto
Interpretojnë: Redi Shypheja - violinë; Aldo Hodja - violonçel; Memela Alija - piano

- “Mes rrugës rruga” (I. Kadriu, 1978) dhe “Përrurim” (Z. Ballata, 1984)
Interpretojnë: Armando Likaj - bariton; Etrita Ibrahimimi - piano

- “Canticum Scodrense” për akordeon e piano (1992). I. Ad libitum; II. Ad misuram; III. Ad libitum bis
Interpretojnë: Elton Balla - akordeon; Ardita Bufaj - piano

- “Balada e Tanës” për recitues, flaut, violinçel e piano (2001)
Interpretojnë: Gëzim Rudi - recitues; Elvis Rudi - flaut; Pjetër Guralumi - violinçel; Ardita Bufaj - piano

- Kaba dhe valle për saksofon alto (2003). I. Liberamente; II. Alla rondellus
Interpreton: Indrit Kodraliu - alto - saksofon

- “Gjëma” për soprano, bas dhe dy piano (1999)
Interpretojnë: Emiljana Palushaj - soprano; Armando Likaj - bariton; Etrita Ibrahimimi - piano 1; Ardita Bufaj - piano 2

- “Hommage a Boletini / Seferi” për violinë e piano (2004)
Interpretojnë: Redi Shypheja - violinë; Memela Alija piano

- “Vallja e maleve” për flaut dhe akordeon (2011)
Interpretojnë: Elvis Rudi - flaut; Elton Balla - akordeon

- “100 vjetë” për recitues, soprano, tenor, bariton, flaut/piccolo, violinë e piano (2012)
Interpretojnë: Gëzim Rudi - recitues; Emiljana Palushaj soprano; Denis Skura - tenor; Armando Likaj - bariton; Elvis Rudi - flaut / piccolo; Lorenc Radovani - violinë; Etrita Ibrahimimi - piano

Dirigjent: Eno Koço

Drejtues Artistik: Lorenc Radovani



ZEQIRJA BALLATA u lind në Gjakovë më 1943 në një familje zejtarësh dhe bartësish të muzikës popullore. Pas shkollës së mesme të muzikës në Prizren ('63), u diplomua me sukses të shkëlqyer ('67) dhe u magjistrua ('69) për kompozitor në Akademinë e Muzikës në Lubjanë te akademikët Matija Bravniçar dhe Lucijan M. Shkerjanc duke realizuar koncert autorial. Ka studiuar edhe muzikologjinë (1965-69) në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Lubjanës. U specializua në Venecie te Virgilio Mortari (VI-VIII '69 e '70), në Accademia musicale Chigiana në Sienë (Itali) te Franco Donatoni (VI-VIII '72 e '73) dhe në Romë te Gofredo Petrassi (tutor '72 - maj '73).

Kompozitor me opus bashkëkohor prej më se 160 veprash pianistike, korale, solistike-instrumentale, kamertale, vokalo-instrumentale e simfonike të botuara në Slloveni, Kosovë, Holandë... të ekzekutuara në festivalë/ koncerthe në Kosovë, Shqipëri, Slloveni, Itali, Kroaci, Austri, Bullgari, Gjermani, Maqedoni, Francë, Mal të Zi. Ka realizuar koncerthe autoriale në vend e jashtë (Lubjanë, Prishtinë, Maribor, Ulqin, Prizren, Gjakovë), etj. Pianist me pjesëmarrje në koncerthe/ festivalë në Kosovë, Slloveni, Itali, Kroaci, Shqipëri, Serbi, Vojvodinë, Austri.

Pedagog në shkollën muzikore "F. Shturm" në Lubjanë (1965-70) dhe në shkollën e lartë pedagogjike në Prishtinë (1971-75). Koautor i Elaboratit për themelimin e Degës së muzikës (1975) të Fakultetit të Arteve; doc. (1975-79), prof. inord. (1980-85) e prof. ord. (1986-91).

Në vitet 1991-2007 këshilltar në Liceun artistik/ Konservatorin muzikor në Maribor. Që nga viti 2007 sërisht prof. ord. për lëndët Kompozicion e Orkestracion në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Veprimtar aktiv në jetën muzikore: në vitet 1971-91 kryetar i Pleqësisë (1975-77), prodekan (1977-79) e dekan Fakulteti (1979-81); bashkëthemelues i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës (1972).

Kryetar i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës (1977-80 e 1990-91). Bashkëthemelues e kryetar i Festivalit "Ditët e muzikës kosovare" (1979). Kryetar i Bashkësisë së Akademive muzikore të RSFJ (1979-80). Kryetar i Shoqatës së pedagogëve muzikorë të Kosovës (1983-85). Kryetar i Garave federative të nxënësve/studentëve të muzikës (1984).

Publicist me veprimtari studimore, librash/ tekstesh universitarë e shkollore, punimesh profesionale-shkencore në shtypin kombëtar e ndërkombëtar, kumtesash në simpoziume, konferenca, kongrese, tribuna muzikologjike. Eshtë i përfshirë në shumë publikime, leksikone dhe enciklopedi.

Anëtar korrespondent (1991) dhe i rregullt (2000) i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

[Http://www.ashak.org/?cid=1,24,125](http://www.ashak.org/?cid=1,24,125)